$$P_o = P_{k1} + P_{k2} + P_{k3} + \dots$$

P_o - janë pikët totale të ofertës së vlerësuar

$P_{k1}/P_{k2}/P_{k3}/\dots$ - janë pikët për secilin kriter të vlerësuar, që mund të jetë kriter me trend zbritës ose me trend rritës.

a) Në rastet e vlerësimit të ofertës ekonomike më të favorshme, për kriteret me trend zbritës, zbatohet formula si më poshtë:

$$P_{k1} = V_{mink1} \times P_{maxk1} / O_{k1}$$

P_{k1} _____ Pikët e kriterit që vlerësohet

V_{mink1} _____ Vlera më e ulët e ofruar për kriterin që po vlerësohet

P_{maxk1} _____ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k1} _____ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

b) Në rastet e vlerësimit të ofertës ekonomike më të favorshme, për kriteret me trend rritës, zbatohet formula si më poshtë:

$$P_{k1} = O_{k1} \times P_{maxk1} / V_{maxk1}$$

V_{maxk1} _____ Vlera më e lartë e ofruar për kriterin që vlerësohet

P_{maxk1} _____ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k1} _____ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

Opsioni 2) – Oferta Ekonomike më e Favorshme, Bazuar në Çmim:

Kontrata do t'i jepet ofertuesit i cili ka ofruar çmimin më të ulët të ofertës.

SHENIM: 1. Autoriteti/Enti Kontraktor do të zgjedhë vetëm një nga Opsionet si kriter i vlerësimit. Përdorimi i të dy opsioneve në DT e bën procedurën të pavlefshme.

2. Autoriteti/Enti Kontraktor përdor si kriter vlerësimi një nga kriteret e përcaktuara në Njoftimin e Kontratës.

3. Autoriteti/Enti Kontraktor do t'i japë kontratën Operatorit Ekonomik, Oferta e të cilit ka rezultuar të jetë ekonomike më e favorshme.

21. Konvertimi në valutë të vetme

Për qëllime vlerësimi dhe krahasimi, monedha (et) e Ofertës do të konvertohet në një monedhë të vetme siç specifikohet në Njoftimin e Kontratës.

22.Korrigjimi i gabimeve aritmetike dhe i ofertës anomalisht të ulët

1. Autoriteti/Enti Kontraktor kontrollon ofertat e paraqitura nëse kanë gabime aritmetike. Nëse ofertat rezultojnë me gabime aritmetike, autoriteti/enti i korrigjon këto gabime si më poshtë:

- (a) Nëse ka ndonjë mospërputhje midis çmimit për njësi dhe çmimit total, që rezulton nga shumëzimi i çmimit të njësisë me sasinë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. Në këtë rast, do të korrigjohet edhe shuma në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin.
- (b) Nëse ka ndonjë mospërputhje tek çmimi total, kur totali është shuma ose diferenca e nëntotaleve, çmimi i nëntotalit mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. Në këtë rast, do të korrigjohet edhe shuma në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin.
- (c) Nëse ka ndonjë mospërputhje ndërmjet shumës në fjalë dhe shumës në shifra, mbizotëron shuma në fjalë. Bën përjashtim nga ky rregull situata kur, shuma në fjalë ka mospërputhje me shumën në shifra, ndërkohë që kjo e fundit nuk ka gabime aritmetike në përlllogaritjen e zërave të ofertës.

Në çdo rast, Ofertat me gabime aritmetike refuzohen kur:

- shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;
- shuma absolute e të gjitha korrigjimeve është më pak se 2%, por nuk pranohet korrigjimi nga ofertuesi.

2. Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% të fondit limit të përlllogaritur.

- Në rast kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve.

Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, duhet t'i kërkojë operatorit ekonomik të paraqesë brenda tre ditëve pune, shpjegime të çmimit ose kostove të propozuara në ofertë, në përputhje me nenin 93 të LPP-së dhe të vlerësojnë informacionin e dhënë, në konsultim me ofertuesin në përputhje me dispozitat e këtij neni.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të justifikojë dhe dokumentojë me prova me shkrim, shpjegime për elementin/elementet specifike të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP-së.

2.1 Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

O - Oferta

MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme

N - Numri i ofertave të vlefshme

PR (Zm) – Zbritje e mundshme

MO = O1 + O2 + O3 + ... On / N

PR = 85 % Mo

Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët.

3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korrigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin/Entin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

D. DHËNIA E KONTRATËS

- | | |
|--|--|
| 23. Njoftimi i Fituesit | 1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti/Enti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese. |
| 24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës | <p>1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti/Enti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.</p> <p>2. Autoriteti/Enti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.</p> <p>Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) mundësi pagese nga ofertuesi në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor; b) garanci bankare; c) garanci nga shoqëri sigurimi. |

DH. ANKESAT

25. Procedura e ankesës

1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.
2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit ose entit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike..

Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

26. Anulimi i procedurës

1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon vendimin përfundimtar për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
2. Autoriteti/ Enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
 - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;
 - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
 - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
 - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;

e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës Ekonomike

Shtojca 2: Formulari i Ofertës ekonomike, për procedurat e prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët nga operatori ekonomik

Shtojca 3: Listat e Çmimeve të artikujve

Shtojca 4: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 5: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i Sasisë dhe Grafikut i lëvrimit

Shtojca 8: Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 9: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 10: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit, në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE³

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontratës;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

³ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

[Në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët, nga operatori ekonomik plotësohet dhe paraqitet vetëm kjo Shtojcë]

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁴

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

c) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontrates;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;

⁴ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës.

d) Norma e fitimit e shprehur në vlerë absolute është si më poshtë:

1	2	3
Nr.	Përshkrimi i mallrave	Norma e fitimit e shprehur ne vlerë absolute

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Kujdes: Bazuar në parashikimet e nenit 45/2.1 të VKM Nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, kur si kriter vlerësimi përdoret “oferta ekonomikisht më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët”, autoriteti/enti kontraktor përllogarit çmimin bazuar në:

- a) çmimin e bursës, së datës kur është publikuar njoftimi i kontratës së procedurës së prokurimit, i konvertuar sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë të kësaj date
- b) elementet fiskale;
- c) normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës;

Shtojca 3.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**
_____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në këtë Formular duhet të plotësohen dhe t'u vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa vlerë do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

1	2	3	4	5	
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Sasia	çmimi per njësi	Çmimi total për artikull (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total (Mallrat)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					

Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 4.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]*

Në emër të: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

* * *

Procedura e prokurimit *[lloji i procedurës]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[objekti]*

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike *[Data]* *[Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-së.*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e *[emri i autoritetit/entit kontraktor]* vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në *[njoftimin e kontratës]*.

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 5.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 6.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

SPECIFIKIMET TEKNIKE DO TI BASHKËNGJITEN DST

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to: **Per mallrat objekt prokurimi, ne kete procedure, ne te gjithë lotet, ne rastet kur specifikimet teknike permbajne parametra dimensionale ose karakteristika te shprehura me vlera fikse, lejohet nje marzhi diferencial prej +- 10 %.**

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

LOTI 1: "BLERJE PAJISJE PËR KABINETET ELEKTROTEKNIKE

No	Pershkrimi	Njesia	Sasia	Grafiku i levrimit te mallit
1	Multimeter dixhital	cope	18	Shkolla profesionale Elbasan
2	Furnizues DC I rregullueshem	cope	9	Shkolla profesionale Elbasan
3	Oscilloscope	cope	4	Shkolla profesionale Elbasan
4	Gjenerator sinjali	cope	4	Shkolla profesionale Elbasan
5	Breadboard	cope	18	Shkolla profesionale Elbasan
6	Arduino UNO/Nano	cope	18	Shkolla profesionale Elbasan
7	Gjenerator 3-fazor 30KVA	cope	1	Shkolla profesionale teknike Korçë
8	UPS 5 KVA	cope	1	Shkolla profesionale teknike Korçë
9	Oshiloskop 220v AC, 10MHz	cope	1	Shkolla profesionale teknike Korçë
10	Makineri elektrike - OPENLAB 0.2 Kw	cope	2	Shkolla profesionale "Beqir Çela" Durrës
11	Elemente P.L.C.	cope	4	Shkolla profesionale "Beqir Çela" Durrës
12	Sistem hibrid per prodhimin e energjise elektrike nga burimet e rinovueshme	cope	4	Shkolla profesionale "Beqir Çela" Durrës
13	Sistem CCTV me 16 kanale	cope	6	Shkolla profesionale "Beqir Çela" Durrës
14	Model trajnimi VFD/PLS 4MD HDMI	cope	3	Shkolla e mesme profesionale "Petro Sota" Fier
15	Model trajnimi SMARTHOME	cope	3	Shkolla e mesme profesionale "Petro Sota" Fier
16	Model trajnimi elektrik dhe elektroteknik	cope	1	Shkolla e mesme profesionale "Petro Sota" Fier

17	Sistem prodhimi dhe akumulimi energjie me panel fotovoltaik 5.5kW	cope	1	Shkolla profesionale teknike Korçë
18	Smart home (Smart Lab) me sistemet kryesore: Ambienti (sensor temperature, lageshtie, alarm, kontroll i HVAC), siguria, pajisje monitorimi, emergjence, aksesit, ventilimi.	cope	1	Shkolla profesionale teknike Korçë
19	Laborator për pajisjet elektroshtepiake (makine larese, tharese, mikrovale, kondicioner, lavastovile, etj.)	cope	1	Shkolla profesionale teknike Korçë
20	Maket ashensori me pajisjet perkatese	cope	1	Shkolla profesionale Elbasan
21	Maket shkallesh levizese	cope	1	Shkolla e mesme profesionale "Petro Sota" Fier

Afati i Levrim: 60ditë nga nënshkrimi i kontrates

LOTI 2 “BLERJE PAJISJE PËR KABINETET E HOTELERI-TURIZËM

Nr .	Pershkrimi	Njesia	Hysen Çela, Durrës	Kristo Isak, Berat	Shkolla profesionale sherbime Korçë	Enver Qiraxhi, Pogradec	Antoni Athanas, Sarandë	Hoteleri - Turizëm, Tiranë	Sasia totale
1	Furre per pasticeri	Cope						1	1
2	aspirator kuzhine	Cope						1	1
3	lavastovilje	Cope						2	2
4	Lavatrice industriale: kapaciteti 10-12 kg me programe te ndryshme per pelhura delikate dhe pambuk , kursim energjie (A+++)	Cope	2	2					4
5	Tharese rrobash (Dryer) Industriale: Kapaciteti 10 kg, me sensore lageshtie per ndalimin automatik	Cope	1	1					2
6	Raft Metalik Inoksi: Per magazinimin e rrobave te pastra dhe produkteve detergjente	Cope	1	1					2
7	Varese rrobash(Stender): Per rrobat qe kerkojne qendrimin vertikal	Cope	1	1					2
8	Dhoma frigoriferike e kombinuar ngrirës-ftohëse me kapacitet 15 m3, Tankers ftohës për qumësht 300 l	Cope			1				1

9	Vitrinë, banak, dollapë, 1 ekspres, 1 frigorifer, aparat për bërjen e akullores, Frigorifer, karrocë shërbimi për kabinetit e bar restorantit	Cope				1			1
10	Pianurë profesionale elektrike (4–6 vatra) me furrë profesionale statike	Cope					1		1
11	Furrë profesionale me konveksion	Cope					1		1
12	Grill / Plancha profesionale	Cope					1		1
13	Fritezë profesionale (1–2 kosha)	Cope					1		1
14	Bain-marie profesionale	Cope					1		1
15	Tenxhere me presion profesionale	Cope					1		1
16	Salamander profesionale (opsionale)	Cope					1		1
17	Aspirator profesional inox me oxhak	Cope					1		1
18	Sistem ventilimi dhe dalje ajri	Cope					1		1
19	Furrë profesionale për pastiçeri	Cope					1		1
20	Mikser planetar profesional (5–10 L)	Cope					1		1
21	Blender profesional	Cope					1		1
22	Shkrirës çokollate / bain-marie çokollate	Cope					1		1
23	Frigorifer profesional pozitiv	Cope					1		1
24	Frigorifer profesional negativ (ngjirës)	Cope					1		1
25	Tavolinë frigoriferike inox	Cope					1		1
26	Frigorifer për pastiçeri	Cope					1		1
27	Ngjirës për semifreddo / produkte të ftohta	Cope					1		1
28	Tavolinë pune me sipërfaqe mermeri (pastiçeri)	Cope					1		1
29	Dollapë inox për ruajtje mjetesh	Cope					1		1
30	Rafte muri inox	Cope					1		1
31	Karroca shërbimi inox	Cope					1		1
32	Lavaman inoks për enë	Cope					1		1

33	Lavaman duarsh me pedal	Cope					1		1
34	Lavastovilje profesionale	Cope					1		1
35	Raft tharjeje për enë	Cope					1		1

Afati i Levrim: 90ditë nga nënshkrimi i kontrates

LOTI 3 “BLERJE PAJISJE PËR KABINETET ME DREJTIM SHËRBIME SOCIALE

PËR SHKOLLËN PROFESIONALE KRISTO ISAK – BERAT

KERKESA PER MATERIALE PER KOMPLETIMIN E KABINETIT TE ANATOMISE SHKOLLA PROFESIONALE KRISTO ISAK - BERAT

Nr	Produkti	Njesia	Sasia
1	Manekin profesional për të rritur, material silikoni të butë i pajisur me gome për kryerjen e injeksioneve IV, IM, SC, ID etj. Per vendosjen e sondës nazale, kateterit dhe ka qafë, shpatulla, bërryla, kyçe, ijë, gjunjë te levizshme, me permasa perafersht 165 cm i gjate, 45 cm i gjere dhe 22 cm i thelle. Pesha rreth 20-25 kg.	cope	1
2	Manekin profesional për foshnje, prej materiali silikoni të butë, i pajisur me gome për kryerjen e injeksioneve IV, IM, SC, etj. Mundëson vendosjen e sondës nazale dhe ka të gjitha pjesët e lëvizshme. Gjatësia: 90 cm, pesha: 6 kg.	cope	1

3	Manekin për ndihmën e parë (CPR), manekin me sipërfaqe të butë, i përshtatshëm për kryerjen e reanimimit kardiopulmonar (CPR). Përmasat: 70 × 35 × 20 cm Pesha: 2 kg	cope	2
4	Set krahu praktike materiali silikon për simulimin e injeksioneve intravenoze (IV). Për foshnje 30-40 cm gjatesi dhe te rritur me permasa 50-60cm e gjate.	cope	2
5	Manekin i përshtatshëm për simulimin e injeksioneve intramuskulare (IM) dhe për demonstrimin e pranisë së dekubituseve (plagëve të shtypjes), materiali silikon I bute.	cope	2
6	Manekin për simulimin e injeksionit intradermal (ID), materiali silikon, i përshtatshëm për simulimin e injeksioneve intradermale.	cope	2

7	Autoklavë (sterilizues me ajër te nxehte), me kapacitet maksimal uji 10-15 L, temperaturë maksimale 140°C, me përmasa 65 × 43 × 45 cm. Material Çeliku inox Derë e sigurt dhe mbyllje me sistem sigurie Kontroll automatik i cikleve me panel LCD/Touch Screen. Opsione programimi për cikle të ndryshme sterilizimi. Sinjalizime vizuale dhe tinguj për fillimin dhe përfundimin e ciklit. Sistem mbrojtës kundër mbinxehjes. Pajisja duhet të jetë në përputhje me standardet ndërkombëtare të sigurisë (CE, ISO ose ekuivalent). Mbrojtje kundër rrymave të tepërta dhe siguri në funksionim. Furnizim: 220–240V / 50–60Hz. Garanci minimale 12 muaj dhe shërbim pas-garancie.	cope	1
8	Pompë vakumi e dedikuar për përdorim me autoklavë sterilizimi, me vakum të qëndrueshëm gjatë ciklit të sterilizimit. Gjerësia e vulosjes: 10 mm Kontroll automatik i vakumit Valvul sigurie dhe sistem mbrojtës ndaj mbinxehjes Gjerësia maksimale e vulosjes 300 mm Kapacitet thithjeje ≥ 60–100 L/min Furnizimi elektrik 220–240 V / 50 Hz Fuqia e motorit ≥ 0.5 kW Nivel zhurme: ≤ 65 dB Material ndërtimi Çelik inox Presion maksimal vakumi ≥ –0.8 bar Temperatura e vulosjes 220°C Përmasat e paketimit 460 × 350 × 220 mm Certifikim CE Garanci minimale 12 muaj Pesha bruto: 6 kg	cope	1

9	Shtrat profesional, portativ, elektrik, materiali Çelik i qëndrueshëm, i ndarë në pjesë (kokë, shpinë, këmbë) me rregullim të pavarur me ngritje të pjesës së sipërme deri në 0-70° dhe ngritje të pjesës së poshtme deri në 0-45°. me mbajtëse krahu të levizshme. 4 rrota të levizshme, me frenim të sigurtë. Kapacitet maksimal mbajtës: 200 kg. Latersi e rregullueshme 45-80 cm, me permasa 200x100x80 (e rregullueshme). Garanci 24 muaj. Me certifikim CE. I pajisur me dyshek.	cope	1
10	Makineri oksigjeni elektrike 5-10 L, me sistem filtrimi dhe monitorimi të integruar. Nivel zhurme ≤ 60 dB Sistem filtrimi me shumë nivele. Ekran dixhital për monitorim të rrjedhës dhe pastërtisë së O₂. Rrota transporti dhe dorezë integrale. Certifikim CE / ISO. Garanci minimale 12 muaj Shkalla e rrjedhjes 1-10l O₂, përqendrimi 90-96%, e permasa 60x40x45, e pajisur me tub dhe maske oksigjeni.	cope	1
11	Karrige manuale me rrota, me lartësi të rregullueshme 45–60 cm, bazë me 4 rrota rrotulluese 360°, rrota të vogla para për manovrim. Materiali Çelik i veshur me bojë ose alumin i lehtë Mbështetëse për shpinë dhe krahë të palevizshme, të rehatshme dhe ergonomike Frenat e sigurt dhe lehtë të operueshme Sedilja dhe mbështetëse për këmbë Material rezistent dhe i lehtë për pastrim Mbështetëse për këmbë të palevizshme dhe të rregullueshme Kapacitet mbajtës: 100-150 kg Certifikim CE	cope	1

12	Paterica te rregullueshme në lartësi 95–135 cm, prej celiku ose alumini të lehtë, me maje gome antirrëshqitese, me mbeshtetese krahu te rregullueshme dhe material ergonomik. Me kapacitet mbajtes deri ne 120 kg. Garanci 12 muaj dhe certifikim CE.	cope	2
13	Databazë elektronike për menaxhimin e të dhënave të pacientëve, vizita, diagnoza, medikamente, procedura dhe trajtime, laborator dhe imazheri, shënime etj. Kontroll aksesit me role , kërkim dhe filtrim i shpejtë i pacientëve. Garanci minimale 12 muaj për softuerin dhe mirëmbajtje.	cope	1
14	Kosha per ndarjen e mbetjeve spitalore (I Verdhe, I kuq, blu) me kapacitet 30 L, Material Polietilen i fortë (HDPE), Pedal dhe bazament i qëndrueshëm dhe mekanizëm hapje, Certifikim CE ose ISO për pajisjet mjekësore Konformitet me udhëzimet WHO dhe autoritetit kombëtar për mbetjet spitalore, deklarate konformiteti.	cope	3
15	Spirometer manual ose elektronik per matjen e kapacitetit te mushkerive, Material rezistent dhe i sterilizueshëm ose me bateri e rikarikueshme, Parametra matës, saktësi matjeje $\pm 3\%$	cope	1
16	Tavolina për nxënës, tavolina rrethore (të bardha) me kornizë anësore të zezë. Kur bashkohen, formojnë një rreth me perimetër 150 cm, dhe lartësi 75 cm, të pajisura me 6 karrige. <i>(Janë 4 sete me nga 6 tavolina ose gjithsej 24 tavolina nëse ndahen në pjesë).</i>	cope	4

17	Tavoline ushqyerje per femije, materiali plastik, me lartesi 100-110 cm.	cope	1
18	Kukull material plastik, per simulim te perkujdesjes per femije ushqyerje, veshje,zhveshje, per profilin kujdesi per femije. Permasa 50-60 cm.	cope	4
19	Tavoline ushqyerje per pacientin, e levizshme, Me permasa te rregullueshme 70-100 cm, Me kapacitet mbajtes 10-20kg. Materiali çelik, sipërfaqja e tavolinës ABS ose MDF i laminuar rezistent ndaj lagështirës dhe dezinfektuesve Përmasa e sipërfaqes se tavolines minimumi 60 × 40 cm Bazament në formë “U” ose “C” për futje nën shtrat Me 4 rrota, të paktën 2 me frenim Skaje të rrumbullakosura për siguri Certifikatë CE për pajisjen	cope	1
20	Raft druri prej MDF (1.8 cm), me imitim druri në ngjyrë të çelët, me lartësi 180 cm, gjerësi 180 cm dhe thellësi 40 cm. Rafti është i ndarë në ndarje 30 × 30 cm.	cope	2

Anatomise Shkolla Profesionale Kristo Isak - Berat

Nr	Produkti	Njesia	Sasia
1	Model didaktik i qelizës shtazore, i ndërtuar me ngjyra dalluese për identifikimin e strukturave kryesore (bërthama, retikulumi endoplazmatik, mitokondritë, ribozomet, aparati i Golxhit, centriolat, lizozomet dhe vakuolat yndyrore). Përmasa: 27 × 20 × 44 cm.	cope	1
2	Model anatomik i sistemit tretës të njeriut (madhësi natyrale), që paraqet traktin tretës nga zgavra e gojës deri te rektumi, me struktura të disekuara për ekspozimin e veçorive të brendshme (zgavra orale, faringu, ezofagu, stomaku, duodenumi, zorra e hollë, cekumi, koloni dhe rektumi). Koloni transversal është i lëvizshëm, ndërsa përfshihet edhe model shtesë relievi i kokës që tregon anatominë e gojës me gjëndrat e pështymës. Përmasa: 90 × 32 × 14 cm; Pesha: 4 kg.	cope	1
3	Model anatomik i apendiksit dhe zorrëve, që paraqet cekumin e hapur me apendiksin, ileumin, orificën ileocecale dhe valvulën, si dhe enët e gjakut dhe nyjet limfatike. Përmasa: 33 × 23 × 8 cm; Pesha: 1.0 kg.	cope	1
4	Model anatomik i zorrëve (2 pjesë), që paraqet cekumin e hapur me apendiksin, ileumin, si dhe orificën dhe valvulën ileocecale, në madhësi natyrale. Përmasa: 16.5 × 11 × 7 cm; Pesha: 0.6 kg.	cope	1

5	Model anatomik i zmadhuar i rektumit , që paraqet strukturën e rektumit. 15x16x41cm	cope	1
6	Model anatomik i stomakut, i hapshëm për të shfaqur strukturën e brendshme të stomakut, duke përfshirë mukozën, pilorin dhe murin gastrik.	cope	1
7	Model anatomik i trurit me pozicione funksionale, i përbërë nga 2 pjesë, që paraqet zona të ndryshme funksionale të korteksit	cope	1
8	Model anatomik i sistemit respirator të njeriut me alveola, në madhësi natyrale, i përbërë nga 7 pjesë, që paraqet laringun , mushkëritë dhe zemrën në 2 pjesë.	cope	1
9	Model anatomik PVC i skeletit të trupit të njeriut, në madhësi natyrale (180 cm).	cope	1
10	Model anatomik i syrit (i zmadhuar 5 herë), i ndare në plan horizontal për të shfaqur detajet e brendshme, kornea, irisi, thjerrëza dhe trupi qelqor janë të heqshme. Paraqiten gjithashtu ngjitjet muskulore në sklerë dhe pjesë e koroidës. Përmasa: 12 × 12 × 12 cm; Pesha: 0.2 kg.	cope	1

11	Model anatomik gjysmë-syri, i syrit të njeriut, që paraqet në mënyrë të detajuar anatominë e brendshme të syrit, thjerrëza dhe kornea janë të heqshme për përdorim edukativ. Modeli përfshin nervin optik, diskun optik, makulën, retinën, arterien dhe venën qendrore të retinës, si dhe kartë edukative shpjeguese me etiketa të pjesëve. Përmasa: 12 × 12 × 14 cm; Pesha: 0.3 kg.	cope	1
12	Model edukativ anatomik i zgavrës nazale, në madhësi natyrale, që paraqet seksionin e hundës me: hundën e jashtme (kocka dhe kërc nazal), zgavrën nazale me murin anësor dhe konkat/turbinatet e sipërme, të mesme dhe të poshtme me kalimet përkatëse nazale, si dhe sinuset nazale (sinusi frontal, sfenoidal dhe maksilar). Përmasa: 12 × 12 × 17 cm; Pesha: 0.6 kg.	cope	1
13	model anatomik i sistemit respirator me alveola, që ilustron sistemin e frymëmarrjes nga sinusi frontal deri te diafragma, duke përfshirë sinuset paranazale, laringun, segmentet bronkopulmonare, si dhe strukturën e rrugëve ajrore intrapulmonare dhe alveolave. Modeli është i përshtatshëm për përdorim edukativ dhe demonstrues. Përmasa: 40 × 26 × 8 cm; Pesha: 2.8 kg	cope	1
14	Model anatomik i zemrës (4 pjesë), që paraqet atriumet (aurikulat), ventrikujt, valvulat kardiake, enët e mëdha dhe muskujt e zemrës; përfshin gjithashtu pjesën e sipërme të ezofagut, bronket e sipërme dhe aortën ascendente. Muri i përparmë i zemrës dhe muret e atriumeve janë të heqshme, modeli është i montuar mbi bazë . Përmasa: 14 × 13 × 28 cm; Pesha: 0.9 kg.	cope	1
15	Model anatomik i trupit të njeriut me ose pa gjini, me gjatësi 26 cm, i përbërë nga 15 pjesë, me pjesën e pasme të hapur, me akses të plotë në sistemet e trupit. Modeli përfshin: bustin, pjesën e syrit, trurin, mushkëritë (4 pjesë), trakenë, zemrën, mëlçinë, stomakun, shpretkën, diafragmën, zorrët, dhe shtyllën kurrizore. Përmasa: 12 × 8 × 26 cm Pësja: 1.5 kg.	cope	1

16	Mikroskop biologjik me zmadhim kokë binokulare sistem objektivash 40x–100x immersion iluminator halogjen / me dritë transmetuese	cope	5
17	Model anatomik i lëkurës së njeriut që paraqet strukturën e shtresave të lëkurës dhe elementet kryesore të saj si epidermën, dermën dhe pjesët e asociuara (sipasne, folikula e qimeve, gjëndrat e djersës dhe yndyrës, enët e gjakut, nervat dhe receptorët).	cope	1

Shkolla Profesionale Rakip Kryeziu Fier

Nr	Produkti	Njesia	Sasia
1	Tavoline levizshme prej druri per ushqyerjen e individeve ne nevoj e pershtatshme prane shtratit te pacienti. Sipërfaqja e tavolinës është 80 cm e gjatë dhe 40 cm e gjerë, me trashesi 1,8 cm me qoshe te rrumbullakosura .Sistemi i ngritjes lejon rregullim të lehtë të lartësisë nga 75.5 cm në 104.5 cm,e cila ndihmon që tavolina të përshtatet me lartësi të ndryshme të shtretërve dhe pozicione të ndryshme të përdoruesit. Baza ka përmasa 61.5 cm me 39.5 cm me një lartësi prej 8 cm, duke siguruar mbështetje të qëndrueshme nën shtretër dhe karrige. Është e pajisur me rrota të heshtura që rrotullohen nëpër dysheme e qëndrueshme gjatë përdorimit. Cope 1.Pesha 7 kg	cope	1
2	Tavoline prej druri e palosshme per ushqyerjen e individeve ne shtrat me siperfaqe 55 cm e gjate ,35 cm e gjere me lartesi prej 21-28 cm. Cope 1. Pesha 3 kg	cope	1

3	Kutia e ndihmes se pare e cila eshte e perbere nga:1 kuti paracetamoli ,1 Thermometer me xhive,1 termometer digital,1 pako pambuk,1 leukoplast shirit ,2 pako doreza sterile,1 shishe betadine, 1 shishe alkool 70 %, 1 pale gersher, 1 drite e vogel, 1 pako bandazhe,10 fasho te vogla , 2 fasha elastic, 2 fasha me paterial pambul shirit, peceta antiseptike , 2bpako bandazhe me 5cm x 4,5 cm, Garza sterile 10x10 cm,kapse per gjuhen Pickatore plastike 1 pako me Asperine.Cope 7.	cope	7
4	Veshje pacienti me material pambul me gjatesi 1,70 cm .Te jete me lidhse ne pjesen anesore ,me kopsa palstik ne pjeset e kraheve . Cope 10	cope	10
5	Oksimeter I cili mat oksigjenin ne gjak dhe lexon ritmin e pulsit ne disa sekonda , e pershtatshme ne te gjitha madhesine e gishtave te femijet mbi 4 vjec deri tek te rriturit.Me ekran led me bateri me permasa 58mm x 31 mm x 32 mm.Cope 10 .	cope	10
6	Kateter venoz perdoret per administrimin e lengjeve intravenoze (infuzione) me filtër ajri me kapak për mbrojtje nga kontaminimi me klem rul për kontroll të lehtë të rrjedhës së lëngut ,port injeksioni për shtim medikamentesh gjatë përdorimit , material plastik . Cope 25 .	cope	25
7	Glukometer profesional me fisha dhe lancet perdoret per matjen e glukozes ne gjak. Madhësia: 97 x 46 x 19 me bateri . Pesha: 50g. Cope 20 .	cope	20
8	Kateter foley profesional me material silikon me dy drejtime ,steril,njeperdorimesh.Pesha 5-15 gr.Pesha 40 cm .Cope 20 .	cope	20

9	Shtrat pacienti elektrik me ngritje shpine 0-70°, ngritje kembesh 0-35°, rregullim lartësie dhe pozicion pjerresie, me anesore plastike. Përmasa të jashtme: 224 × 96 cm Sipërfaqe fjetjeje: 202 × 88 cm. Lartësi e rregullueshme: 39 – 80 cm. Kapacitet maksimal: 150 kg. Cope 3.	cope	3
10	Paterica profesional mbështetëse profesionale me 4 këmbë me material alumini të lehtë dhe të rregullueshme në lartësi. Lartësia 70cm-90 cm. Cope 5.	cope	5
11	Manikin profesional pediatrik me material silikoni i fortë, rezistent, me ndjesinë e kompresive për masazhin kardial (CPR), simulues i rrugëve sjorre, model shpëtimi i thithjes së trupit të huaj, mbytyedhe model për simulime në të gjithë trupin. Gjatesia 60 cm, Peshë 3kg. Cope 5 (pese).	cope	5
12	Manikin profesional për të rritur me material silikoni të fortë rezistent, me ndjesinë për kompresive për masazhin kardial (CPR). Model gjysem trupi, me ngritje reale të gjoksit, me rrugë ajrore dhe jelek të heqshëm. Gjatesia 70 cm gjersi 36 cm, Peshë 7 kg. Cope 3 (tre).	cope	3
13	Manikin profesional pacient me material plastik me gjymtyrë të palosshëm. Me gjatësi 170 cm. Cope 3.	cope	3
14	Stativ profesional për mbajtje të perfuzioneve I/V prej materiali metalik. Gjatesia 1,80 m. Cope 5	cope	5
15	Perde profesionale ndarë të levizshme me 3 pjesë dhe të palosshme, Gjersia 50 cm, gjatesia 230 cm dhe lartësia 180 cm. Cope 2.	cope	2

16	Karrige profesionale me oturak ,rezistente ndaj lageshtires me sedilje dhe mbeshetje e shpines te mbushura me sfungjer ,uturaku me ene plastike e levizshme e vendosur poshte sediljes e lehte per tu hequr dhe pastruar.Gjeresi 55 cm , Lartesi 90 cm , Gjatesia 85 cm .Pesha 10 kg . Cope 2 .	cope	2
17	Aparat aerosoli (nebulizator) professional me material plastic te fort mjeksore per thithjen e e medikamentit ne forme grimcash ,punon me prize elektrike .Permban maska me material silicon per te rritur dhe femije .Gjatesi 20 cm,Gjersi 15 cm , Lartesi 12 cm. Pesha 1 kg. Cope 5 .	cope	5
18	Skelet professional anatomic te trupit te njerit e perber vetem me pjeset e kockave te levizshme .Me material plasti te fort dhe rezistent ndaj perdorimeve. Gjatesia 25 cm . Lartesia 40 cm .Pesha 3 kg. Cope 2.	cope	2
19	Model professional anatomici trupit te njeriut me organe qe hiqen rezistent ndaj konsumit me material plastic te forte , Lartesia 85 cm.Gjersi 40 cm Pesha 8 kg.Cope 2 .	cope	2
20	Set carcafesh professional qe permban 1 carcaf per shtrim me permasa gjersi 140 cm dhe gjatesi 240 cm , carcaf per mbulim me permasa gjersi 160 dhe gjatesi 240 dhe 1 kellefje jasteku me permasa gjersi 50 , gjatesi 80 cm me material poliestre te bardhe .Pesha 1,5 kg . Cope 5 .	cope	5
21	Peshqira me material me perzierje pambuku ne permasa 40 x 40 cm .Pesha 50 gr per cope . Cope 5.	cope	5
22	Termometer professional me zhive qelq . Gjatesia 13 cm , Pesha 20 gr .Cope 20	cope	20

23	Termometer professional digital me matrial plastike te forte per matje aksilare,orale dhe rektale . Gjatesia 12 cm,Pesha 20 gr . Cope 10 .	cope	10
24	Termometer profesional me ngjitje ne ball me material plastic te forte ,rezistent ndaj perdorimeve. Termometri shirit me sensore temperature , I cili mat per 15-20 sekonda dhe sensori perkates ndryshon ngjyren . Gjatesia 5 cm .Cope 10 .	cope	10
